



AGJENCIA E REGJISTRIMIT CIVIL
AGJENCIA ZA CIVILNU REGISTRACIJU
CIVIL REGISTRATION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E PUNËVE TË PËRINDSHME-MINISTARSTVO UNUTRASNIJH POSLOVA
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
AGJENSIONI I REGJISTRIMIT CIVIL-AGENCIJA ZA CIVILNU REGISTRACIJU
CIVIL REGISTRATION AGENCY

Nr./Br./No. 02 Nr./Br./str./No./pg. 4606
Data/Datum/Date 28/06/2019
PRISHTINË - PRISHTINA - PRISTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Fondi i Sigurimit Shëndetësor/Fond za
Zdravstveno Osiguranje/Health Insurance Fond

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR-FOND ZA ZDRAVSTVENO OSIGURANJE
HEALTH INSURANCE FUND

Njësia Org. FSSH Nr. Prot. 1409
Org. Jedinica FSSH Broj Prot. 1409
Org. Unit. FSSH Prot. No. 1409
Nr. i faqeve -4- Data 28.06.19
Br. stranica -4- Datum 28.06.19
No. pages -4- Date 28.06.19
PRISHTINË - PRISHTINA - PRISTINA

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
AGJENCISË SË REGJISTRIMIT CIVIL
DHE
FONDIT TË SIGURIMIT SHËNDETËSOR
PËR
SHKËMBIM TË TË DHENAVE**

Agjencia e Regjistrimit Civil (në tekstin e mëtejshëm – ARC)

dhe

Fondi i Sigurimit Shëndetësor (në tekstin e mëtejshëm - FSSH), janë pajtuar si më poshtë:

Neni I **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim shkëmbimin e të dhënave në mes të ARC dhe FSSH.
2. Shkëmbimi i këtyre të dhënave mundëson identifikimin e sakte të të dhënave përkatëse dhe lehtëson proceset e punës tek këto institucione.

Neni II **Përdorimi i të dhënave**

1. Përdorimi i të dhënave do të mundësohet vetëm për lexim (read-only) dhe do të jetë i qasshëm vetëm nga përdorues të autorizuar.
2. ARC dhe FSSH do të hartojnë dokumentin e Procedurës Standarde të Operimit (PSO) si udhëzues për shkëmbimin e shënimeve përmes të cilit do të definohen të dhënat të cilat do të shkëmbehen në mes të këtyre dy institucioneve.

Neni III **Përgjegjësitë e ARC**

1. ARC siguron që të dhënat që i shkëmbehen të jenë të përditësuara dhe të qasshme sipas mënyrës së shkëmbimit të këtyre të dhënave.
2. ARC mban evidencë lidhur me të dhënat që shkëmbehen.
3. ARC pajtohet që të dhënat që i shfrytëzon janë konfidenciale dhe si të tilla do të përdoren vetëm për qëllime të këtij memorandumi dhe të njëjtat nuk do të shpërndahen tek palët tjera të paautorizuara.
4. ARC obligohet të ruaj fshehtësinë dhe të mbajë të sigurta të dhënat e shkëmbyera.

Neni IV
Përgjegjësitë e FSSH

1. FSSH siguron që të dhënat që i shkëmbehen të jenë të përditësuara dhe të qasshme sipas mënyrës së shkëmbimit të këtyre të dhënave.
2. FSSH mban evidencë lidhur me të dhënat që shkëmbehen.
3. FSSH pajtohet që të dhënat që i shfrytëzon janë konfidenciale dhe si të tilla do të përdoren vetëm për qëllime të këtij memorandum dhe të njëjtat nuk do të shpërndahen tek palët tjera të paautorizuara.
4. FSSH obligohet të ruaj fshehtësinë dhe të mbajë të sigurt të dhënat e shkëmbyera.

Neni V
Mbrojtja e të dhënave personale

Të dhënat që shkëmbehen në mes të ARC dhe FSSH nuk duhet t'i tejkalojnë qëllimet për të cilat ato janë grumbulluar dhe/ose përpunuar. Përpunimi dhe përdorimi i të dhënave personale nga ky memorandum duhet të bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni VI
Dispozitat përfundimtare dhe kalimtare

1. Ky Memorandum lidhet për afat të pacaktuar.
2. Të gjitha mosmarrëveshjet eventuale duhet të zgjidhen me konsultim dhe mirëkuptim në mes të palëve.
3. Ky Memorandum mund të ndërpritet në çdo kohë nga cilado palë nënshkruese në rast të mos përmbushjes apo shkeljes së përgjegjësisive të përcaktuara.
4. Memorandumi mund të shkëputet në çdo kohë me një paralajmërim me shkrim, së paku një muaj para datës së ndërprerjes.

Neni VII

Hyrja në fuqi


1. Palët nënshkruese pajtohen që ky Memorandum Bashkëpunimi fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit nga ana e tyre.
2. Me nënshkrimin e këtij Memorandumi, palët obligohen në zbatimin e plote të dispozitave të këtij Memorandumi.

Palët nënshkruese

Bekim Hoxha



Drejtore i Përgjithshëm i ARC




Data e nënshkrimit (ARC)

Fatmir Plakiqi



Drejtore i FSSH



Data e nënshkrimit (FSSH)